

Tiranë, 14 / 09 / 2022

## LETËR INFORMUESE

**Të nderuar prindër,**

**TES** ka hapur dyert e Tij në 12 Shtator dhe në bashkëpunim me Ju, kemi për të ecur një rrugë të gjatë në edukimin dhe zhvillimin e fëmijes.

- Mësuesit dhe stafi ynë mbështetës, këtë vit shkollor do të zhvillojnë programin kurrikular shtetëror dhe do ta shoqërojnë atë me komponentë të rinj të mësimëdhënies dhe suportit të nxënësve sot, për një edukim dhe formim si një individ i denjë për shoqërinë nesër .
- Përveç kësaj, ne do të zhvillojmë më tej një Program Veprimi dhe Shërbimi ku do të integrohen studimi dhe aktivitete (**Klube**) pas –shkollore (after-school activities) të cilat do të përfshijnë një gamë të gjerë të aktiviteteve fizike, artistike dhe akademike duke nxitur kështu edhe zbulimin dhe zhvillimin e talenteve tek fëmijët.
- Së bashku me programin klasik mësimor, një nga pikat e forta të programit të veprimit që do të përdoret në **TES** do të jetë edhe komunikimi me nxënësit në një orë mësimi / këshillimi, kjo për të ndihmuar fëmijën Tuaj të zhvillohet dhe më pas të integrojë këto këshilla në funksion të nxënies dhe sjelljes.
- Filozofia e **TES**, është nxitja dhe zhvillimi i vazhdueshëm dhe shumëdimensional i aftësive të të nxënësve dhe edukimit të fëmijes.

Nëpërmjet kësaj letre Informuese Ju prezantojmë, procedurën e informimit për ecurinë e fëmijës Tuaj, në fillim dhe përgjatë këtij viti shkollor. Ju do të keni mundësinë të njiheni mbi aftësitë e fituara apo të zhvilluara të fëmijës Tuaj, me qasjen e tij ndaj të nxënësve, komunikimit, shkencës apo edhe për zhvillimin e mendimit kreativ dhe kritik. Informimi do të ketë në fokus edhe mënyrën, se si këto aftësi janë përthithur nga secili nxënës në mënyrë të përgjithshme dhe të veçantë.

Takimet informuese të **TES** do të jenë mujore dhe do të shoqërohen me raporte mbi përparimin dhe zhvillimin e fëmijës suaj, duke theksuar qasjet dhe metodat e përdorura.

Raporti që do të shoqërojë letrën informuese, do të trajtojë vlerësimet e ndryshme formative dhe përmbledhëse të objektivave që janë plotësuar nga fëmija Juaj, gjatë gjithë periudhës mbi të cilën po raportohet.

Informimi mbi ecurinë e fëmijës tuaj do të bëhet me paraqitjen e vlerësimit të kryer nga shkolla në dy aspekte :

1. Vlerësimi bazuar në rezultatet e të nxënit, që përfshin gjykimin për arritjet e nxënësve (njohuri, shkathtësi, vlera dhe qëndrime) përkundrejt niveleve të arritjes së kompetencave të të nxënit
2. Vlerësimi me notë do të tregojë nivelet e arritjeve për secilën lëndë sipas legjislacionit arsimor ne fuqi.
  - **Takimet/konferencat me prindër, do të jenë të planifikuara apo të paplanifikuara.**

Takimet /konferencat janë planifikuar të bëhen 1 herë në muaj sipas datës së skeduar dhe miratuar nga drejtoria, prindërit do të informohen nga sekretaria nëpërmjet postës elektronike, apo shkresës së dërguar fizikisht nëpërmjet fëmijës.

- **Takimet e paplanifikuara me prindërit kërkohen nga institucioni apo dhe nga vetë prindi.**

Nëse do të ketë raste me fëmijë që hasin vështirësi në nxënie, apo probleme në sjellje me shokët, mësuesit apo stafin mbështetës duke thyer rregulloren e shkollës, sekretaria e shkollës do t'ju informojë nëpërmjet një kërkesë për takim një ditë përpara ku do t'ju bëhen me dije dhe arsyet.

Gjithashtu, në rastet kur prindi kërkon të takohet me mësuesit apo drejtorin e shkollës për mbarëvajtjen e fëmijës, Ai është më se i mirëpritur në **TES**, duke njoftuar një ditë përpara sekretarinë e shkollës për lënien e një takimi me mësuesin kujdestar apo drejtuesin, bazuar në tabelën e disponibilitetit dokument që do të shoqërojë këtë letër.

Drejtoresha e Shkollës **TES** Luljeta Basha cel 0684010603

Sekretaria e shkollës **TES** cel 0693700037

Drejtoresha e Shërbimeve në GEA Arjola Hoxha cel 0697035593

Departamenti i Financës në GEA 0697014291

Duke shpresuar që kjo Letër të jetë informuese mjaftueshëm për Ju, mbetemi në pritje të prezencës Tuaj në takimin/konferencën e radhës .

Urojmë për Ju dhe fëmijën tuaj një vit shkollor të suksesshëm!

**“Tomorrow`s Education System”**  
**TES**

Luljeta BASHA  
DREJTOR